



# Trusti

TRUSTI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS KOSOVO PENSION SAVINGS TRUST TRUST KOSOVSKIH PENZIONIH ŠTEDNJI

NLB Banka sh.a.  
Nr. 5857 Data 30-06-2016  
Prishtinë

## KONTRATË PËR SHËRBIME

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), me seli në Prishtinë, Rr. Agim Ramadani Nr.182-184 ("Autoriteti Kontraktues")

dhe

NLB Prishtina SH.A, me zyrën kryesore që gjendet në Rr. Ukshin Hoti, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 70053484 dhe me numër fiskal 600184098 ("Ofruesi i Shërbimeve")

janë pajtuar si në vijim:

Për të përmbyllur këtë kontratë për: <Shërbimet bankare për térheqjen në fazë të kontributave pensionale

Numri identifikues : <FKPK-TF-2016\_NLB >

### Neni 1: Lënda e Kontratës

Lëndë e kësaj kontrate është rregullimi i të drejtave dhe obligimeve në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve lidhur me implementimin e shërbimeve bankare për térheqjen në fazë të kontributave pensionale, në përputhje me afatet dhe kushtet e parapara në këtë kontrate, si dhe në përputhje me ofertën e datës 11/05/2016 e cila është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

### Neni 2: Kohëzgjatja e Kontratës

- 2.1 Kjo Kontratë hynë në fuqi me datë 01.07.2016 dhe skadon me datë 30.06.2019,
- 2.2 Kushtet dhe Afatet e kësaj kontrate do të mbeten në fuqi, për të gjitha Llogaritë e Kryegjësë me bilanc pozitiv, edhe kur kjo kontratë skadon.
- 2.3 Palët, në çdo rast të ndërprerjes së kontratës, do ta njoftojnë me shkrim njëra-tjetër për këtë së paku 90 ditë para ditës kur është menduar të ndërpriten shërbimet.

### Neni 3: Çmimi

- 3.1 Autoriteti Kontraktues dhe Ofruesi i Shërbimeve janë pajtuar që, për shërbimet e ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve, të aplikohen çmimet e përcaktuara në Ofertën e datës 11/05/2016 e cila do të konsiderohet si pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë të bëjë ndryshime të çmimeve për shërbimet e ofruara në bazë të kësaj kontrate dhe te cilat janë të parapara në ofertën e datës 11/05/2016 gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate.

#### Neni 4: Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

- 4.1 Ofruesi i Shërbimeve është i obliguar të hapë Llogari të Kryegjësë për secilin person të pensionuar i cili paraqitet në zyrat e Ofruesit të Shërbimeve dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet e parapara nga Ofruesi i Shërbimeve për hapje të llogarive, dhe do t'i kreditojë ato me shumat relevante në ditën e fundit të punës të muajit.
- 4.2 Ofruesi i Shërbimeve, me të hapur Llogarinë e re të Kryegjësë, do t'ia kthejë AK-së të dhënat në vijim: Numrin Personal, Llogarinë e Kryegjësë (llogari në të cilën do të mbahet shuma totale e mjeteve që i takojnë një të pensionuar), Llogarinë e Pagesës (nëse është e ndryshme prej asaj të kryegjësë dhe në të cilën do të bëhet pagesa mujore për të pensionuarin, në përputhje me udhëzimet nga AK).
- 4.3 Ofruesi i Shërbimeve do të paguajë ose vejë në dispozicion në Llogarinë e Pagesës, jo më larg se në ditën e dytë të punës të secilit muaj shumën për pagesë, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga AK dhe derisa Bilanci i Kryegjësë të arrijë shumën zero.
- 4.4 Kamata do të përllogaritet në baza ditore dhe do të paguhet në Llogarinë e Kryegjësë në bazë mujore, në ditën e fundit të secilit muaj, bazuar në Bilancin e Kryegjësë në çdo ditë të muajit. Kamata do të jetë kombinim (EURIBOR 6-mujor dhe -1%) ose 1.5% vjetore, cilado që të jetë më e lartë. Nëse duhet të përdoret kombinimi, për llogaritjen fillestare do të merret për bazë EURIBOR-i i datës së transferit të parë nga Autoriteti Kontraktues, kurse për periudhat tjera EURIBOR-i do të ndërrojë me datat 1 janar (me EURIBOR-in e ditës paraprake) dhe 1 korrik (me EURIBOR-in e ditës paraprake) të çdo viti deri në shterrimin e bilancit në secilën llogari. Kjo mënyrë e llogaritjes do të aplikohet për të gjitha llogaritë me këtë kontratë.
- 4.5 Ofruesi i Shërbimeve është i obliguar që, secilin të pensionuar që hap llogari të pagesës, ta pajisë me kartelën e debitit (me këtë kartelë klienti do të mund të bëjë térheqjen e mjeteve nga ATM).
- 4.6 Ofruesi i Shërbimeve është i obliguar që në afat deri 90 ditë nga nënshkrimi i kësaj kontrate, ta përshtat sistemin e TI-së në atë mënyrë që të jetë i gatshëm për të ofruar Shërbimin e Térheqjes në Faza.
- 4.7 Ofruesi i Shërbimeve është i obliguar që, për secilën pagesë mujore të ekzekutuar në llogarinë e pagesës, të zbres të gjitha tatimet e aplikueshme në të ardhurat personale të parapara nga ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- 4.8 Raporti mujor i dërgohet FKPK-së për Bilancin e Llogarive të Kryegjësë, Debitimin/Kreditimin dhe Normën e aplikuar të Kamatës.
- 4.9 Në rast të vdekjes së Pensionistit, para se Bilanci në Llogarinë e Kryegjësë të arrijë shumën zero, Ofruesi i Shërbimeve obligohet që pagesat mujore t'i transferojë tek trashëgimtar/trashëgimtarët e tij, në përputhje me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- 4.10 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ngarkojë asnjë komision për hapjen e Llogarisë së Kryegjësë ose Llogarisë së Pagesës, e as për mirëmbajtjen e këtyre llogarive, ose për kreditimin e Llogarisë së Pagesës me pagesën në rastet kur Llogaria e Pagesës është e hapur tek Ofruesi i Shërbimeve.
- 4.11 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ngarkojë kurrrfarë komisionesh për térheqjet nga Llogaria e Pagesës më të larta se komisionet standarde që ngarkohen nga Ofruesi i Shërbimeve për térheqje të tillë.
- 4.12 Ofruesi i Shërbimeve duhet që me kërkesë të Autoritetit Kontraktues të ofrojë informata mbi detajet e Llogarisë së Pagesës.
- 4.13 Ofruesi i Shërbimeve mund të ngarkojë tarifa standarde për transferimin e pagesës mujore në Llogarinë e Pagesës që nuk është e hapur tek Ofruesi i Shërbimeve, në të cilin rast kjo tarifë do të zgjedhjë pagesën që arrin në Llogarinë e Pagesës.

A  
Z  
B  
G

- 4.14 Pensionisti ose trashëguesit e tij/saj nuk do të ngarkohen me ndonjë tarifë për lëshimin fillestare të debit kartelës (me këtë kartelë klienti do të mund të bëjë térheqjen e mjeteve nga ATM), e as për lëshimet e pastajme të kartelave të skaduara ose mirëmbajtjen e tyre.
- 4.15 Ofruesi i Shërbimeve do t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në veçanti sipas Ligjit për Fondet Pensionale 04/L-101, Rregulloreve për Pensione të Bankës Qendrore të Kosovës, si dhe do të sigurojë që personeli i tij, gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve. Ofruesi i Shërbimeve do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat dhe procedurat që mund të shfaqen nga ndonjë shkelje e ligjeve dhe rregulloreve të tillë nga ana e Ofruesit të Shërbimeve, punëtorëve të tij dhe të varurve të tyre.
- 4.16 Ofruesi i Shërbimeve duhet të vazhdojë me aplikimin e të gjitha detyrave, përgjegjësive dhe kushteve të kësaj kontrate edhe pas skadimit të kontratës për pjesëmarrësit në programin e térheqjes në fazë të cilët akoma nuk i kanë shtetur llogaritë e tyre të Kryegjësë.
- 4.17 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për te gjitha humbjet dhe kërkesat lidhur me aktivitetet e shërbimeve në rast se vërtetohet se ka vepruar në kundërshtim me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate.

#### **Neni 5: Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

- 5.1 Autoriteti Kontraktues është i obliguar që t'i sigurojë me kohë Ofruesit të Shërbimeve cilëndo informatë dhe/apo dokument që ka ne dispozicion të cilat mund të janë relevante për performim të kontratës.
- 5.2 Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i dërgojë Ofruesit të Shërbimeve të gjitha informatat që kanë të bëjnë me transferet dhe të cilat duhet të përbajnë, për secilin të pensionuar, të dhënat e tillë si: emri, mbiemri, numri personal, data e lindjes, adresa, shuma e Kryegjësë, pagesa mujore, llogaria e pagesës, dhe çdo informate tjeter të nevojshme në mënyrë që të realizohen pagesat.
- 5.3 AK është i obliguar që të jap të dhëna të sakta për procesim të pagesave në Llogarinë e Kryegjësë dhe në atë të Pagesës. Sidoqoftë, AK rezervon të drejtën të kthejë prapa cilëndo shumë deri në shumën e bilancit të Llogarisë së Kryegjësë, e cila përcaktohet nga AK t'i jetë atribuuar gabimisht Pensionistit, pa kurrrafë kostoje përvèç kostos së transferimit të fondeve të tillë në llogarinë e AK në BQK.
- 5.4 AK rezervon të drejtën të bëjë kreditim shtesë në Llogaritë ekzistuese të Kryegjësë për secilin të pensionuar.
- 5.5 Autoriteti Kontraktues është i obliguar që, në rastet kur ndryshon pagesën mujore të një apo më shumë pjesëmarrësve/pensionerëve, të njoftojë Ofruesin e Shërbimeve më së paku pesë (5) ditë paralajmërim.

#### **Neni 6: Nën-kontraktimi**

- 6.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.
- 6.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.
- 6.3 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## Neni 7: Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

- 7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyë:
- a) Autoriteti Kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
  - b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 8;
- 7.2 Brenda 5 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Ofruesi i Shërbimeve duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kérkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Ofruesit të Shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kérkesa.
- 7.3 Brenda 5 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 7.2 Autoriteti Kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojoë Ofruesin e Shërbimeve që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

## Neni 8 : Forca madhore

- 8.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.
- 8.2. Termi "forca madhore" do të thotë veprimet e natyrës, goditjet, mylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetat, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet edhe me kujdesin e duhur.
- 8.3. Pala e ndikuar nga një rast i forcës madhore do të ndërmerr te gjitha masat e arsyeshme për te mënjanuar të gjitha pamundësitë e asaj pale për të përbushur obligimet me një minimum vonese.
- 8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje për shkak të shkeljes nëse vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Kontraktuesi për shkelje të kontratës, nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.
- 8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat.

## Neni 9: Konfidencialiteti

- 9.1 Ofruesi i Shërbimeve dhe Autoriteti Kontraktues pajtohen se Informacioni Konfidencial që është siguruar përmes ekzekutimit te kësaj kontrate, duhet të konsiderohet dhe trajtohet si konfidencial dhe pronë e secilës palë kontraktuese. Palët duhet të sigurohen që informacioni konfidencial dhe i ndjeshëm të ruhet si konfidencial në çdo kohë dhe të mos përdoret për asnjë qëllim tjetër përvèçse për qëllimin e kryerjes me sukses të detyrate dhe përgjegjësive të cilat rrjedhin nga kjo kontratë.
- 9.2 Palët nuk do të zbulojnë, publikojnë ose përndryshe të jatin ndonjë nga informatat konfidencale të siguruara gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate tek ndonjë palë tjetër për çfarëdo arsy, gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje si dhe pas përfundimit apo skadimit të marrëveshjes së fundit të vlefshme ndërmjet palëve. Palët janë të informuara dhe janë të vetëdijshme se zbulimi i informatës konfidencale përbën vepër penale dhe është i sankzionuar me Kodin Penal të Kosovës.

ndërmjet palëve. Palët janë të informuara dhe janë të vetëdijshme se zbulimi i informatës konfidenciale përbën vepër penale dhe është i sankzionuar me Kodin Penal të Kosovës.

#### Neni 10: Shkelja e kontratës

- 10.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të përmbush ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.
- 10.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto masa dhe kompensime:
  - a) dëmet; dhe/ose
  - b) ndërprerjen e kontratës.

#### Neni 11: Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

- 11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë ofruesit të Shërbimeve shtatë (7) ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:
  - a) Ofreusit të Shërbimeve i pezullohet Licenca nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;
  - b) Ofreusit të Shërbimeve vendoset nën masa emergjente apo nën masat e revokimit të licencës nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
  - c) Ofreusi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
  - d) Ofreusi i Shërbimeve e bartë kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
  - e) Ofreusi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nationale;
  - f) Ofreusi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
  - g) Ofreusi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
  - h) Ofreusi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtirim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
  - i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- 11.2 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofreusin të Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet
- 11.3 Me rastin e ndërprerjes së kontratës apo mos-përmbushjes së obligimeve të kontratës nga Ofreusi i Shërbimeve pas skadimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë kthimin e mjeteve nga disa apo të gjitha llogaritë e pjesëmarrësve në programin e tërheqjes me fazë të cilët akoma nuk i kanë shtetur llogaritë e tyre të Kryegjësë.

#### Neni 12: Ndërprerja nga ana e Ofreusit të shërbimeve

- 12.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve.
- 12.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.
- 12.3 Në rast të ndërprerjes së tillë, Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve për humbjet ose dëmet që mund t'i janë shkaktuar.

**Neni 13: Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

- 13.1 Dokumentet e referuara, shtojcat, apo çfarëdo dokumenti tjetër që kanë lidhje me implementimin e kësaj kontrate kanë radhitjen e përparësisë si në vijim, duke filluar nga më e rëndësishmja:
  - Kjo konratë;
  - Oferta për kontraktimin e "Shërbimeve bankare për tërheqjen në fazë të kontributave pensionale";
  - Oferta Financiare e Ofruesit të Shërbimeve;
- 13.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën do të konsiderohen se shpjegojnë njëra tjetrën, në rastet e paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit në të cilin janë paraqitur më sipër.

**Neni 14: Ndryshimi, Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Ligji i Aplikueshëm dhe Komunikimet**

- 14.1 Komunikimet ndërmjet Autoritetit kontraktues nga njëra anë, dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër, do të janë ekskluzivisht në formë të shkruar dhe duhet të cekët Titulli i Kontratës dhe numri identifikues. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, e-mail, ose të dorëzohen personalisht.
- 14.2 Njoftimet, kërkesat dhe komunikimet tek Ofruesi i Shërbimeve dhe Autoriteti Kontraktues, përvëç nëse specifikohet adresë tjetër me shkrim, do të dërgohen tek adresa e treguar më poshtë, të cilët njëkohësisht janë personat përgjegjës për implementimin e kësaj kontrate:



- 14.3 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre lidhur me zbatimin e kësaj kontrate. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës.
- 14.4 Nëse palët dështonin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyre miqësore, siç është paraparë në paragrafin \_\_\_ më lartë, atëherë secila palë mund t'i drejtohet gjykatës kompetente në Republikën e Kosovës.
- 14.5 Kjo konratë do të qeveriset nga rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- 14.6 Kjo konratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe 1 (një) origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized letters and numbers, is located in the bottom right corner of the page.

**Aneksi II****ANEKS KONTRATE**

Referuar kontratës bazë të datës 30.06.2016 e identifikuar si "FKPK-TF-2016\_NLB", me titull "Kontratë për Shërbime" lidhur në mes të:

**Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës** (FKPK), me seli në Prishtinë, Rr Agim Ramadani Nr. 182-184 (referuar si "Autoriteti Kontraktues - AK") dhe

**NLB Banka SH.A**, me zyrën kryesore që gjendet në Rr. Ukshin Hoti, nr.124 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër unik identifikues **810486250**, numër të biznesit **70053484** dhe me numër fiskal **600184098** (referuar si "Ofruesi i Shërbimeve"),

Të dytë bashkë referuar më tej si "Palët".

**Neni 1: Ndryshimet**

Përmes kësaj aneks Kontrate, te Identifikimi për Ofruesin e Shërbimeve, shtohet Numri Unik Identifikues **810486250**, me të cilin është pajisur pas nënshkrimit të kontratës bazë, si dhe ndryshohet emri i Ofruesit të Shërbimeve nga NLB Prishtina SH.A në NLB Banka SH.A.

Përmes kësaj aneks kontrate, kontratës bazë, palët pajtohen që Ofruesi i Shërbimeve, në baza të rregullta mujore t'i sigurojë AK-së disa pasqyra të llogarisë së të pensionuarve, të cilat përzgjidhen në mënyrë rastësore sipas kërkesës nga AK.

Gjithashtu përmes kësaj aneks-kontrate, ndryshohet nen 14, paragrafi 14.2, bëhën ndryshime në emërtime sa i përket palëve kontraktuese për shkak të nje gabimi teknik ku si rrjedhojë në pjesen që i përket njoftimeve, kërkesave dhe komunikimeve, janë evidentuar të dy palët si Autoritet Kontraktues, andaj tanë e tutje NLB Banka sh.a paraqitet si Ofrues i Shërbimeve ndërsa Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës paraqitet si Autoritet Kontraktues.

Në këtë paragraf të këtij nen poashtu ndryshohet personi kontaktues për Ofruesin e Shërbimeve (NLB Banka sh.a), ku tanë e tutje person kontaktues do të jetë.

**Për Ofruesin e Shërbimeve**

Dafina Hasani-Ibrahimi

Rr "Ukshin Hoti" nr.124  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.  
Nr. 038 744 130

**Neni 2: Kohëzgjatja**

Përmes kësaj aneks kontrate, vazhdohet afati i Kontratës për Shërbime e lidhur në mes të palëve me datë 01.07.2016, dhe vazhduar deri me 30.06.2022, përmes aneks kontratës me datë 01.07.2019.

Kohëzgjatja e Kontratës Bazë, përmes kësaj aneks kontrate, vazhdohet edhe për 3 vite pasuese, nga data 01.07.2022 deri me datën 30.06.2025.

**Neni 3: Vlefshmëria e Kushteve të kontratës bazë**

Palët pajtohen që përveç ndryshimeve të paraqitura në nenin 1 dhe 2 të kësaj aneks kontrate, të gjitha kushtet e kontratës bazë të pandryshuara me anë të këtij aneksi mbresin në fuqi.

**Neni 4: Gjuha dhe numri i kopjeve**

Kjo aneks-kontratë është hartuar në gjuhën shqipe, në tri kopje origjinale, një për Ofroesin e Shërbimeve dhe dy për Autoritetin Kontraktues, dhe e njëjta është pjesë përbërëse e Kontratës Bazë së cilës i bashkangjitet si "Aneksi II".

*Nënshkruar në Prishtinë nga:*

**Për Ofroesin e Shërbimeve**

Emri:	<i>LAVDIM</i>
Pozita:	<i>Kryetari BORBI "UKEQES"</i>
Nënshkrimi:	<i>Lavdim</i>
Data:	<i>06.06.2022</i>
Vula:	



**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	<i>ADMIR ZAKI</i>
Pozita:	<i>DIM</i>
Nënshkrimi:	<i>Zak</i>
Data:	<i>17.6.2022</i>
Vula:	

**Për Ofroesin e Shërbimeve**

Emri:	<i>ALBERT</i>
Pozita:	<i>KRYETARI BORBI "UKEQES"</i>
Nënshkrimi:	<i>Albert</i>
Data:	<i>06.06.2022</i>
Vula:	

